

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020

1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqëria “SA’GA - MAT” Sh.p.k. me NUIS L11814001B, eshte themeluar me datë 10/02/2011, nga ortakët shoqëria “Sigers” sh.p.k. dhe shoqëria “Sina-98” sh.p.k. të cilet e kanë regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare me datë 14/06/2011, me kapital te nenshkruar prej 100,000 Leke, me kohëzgjatje të kufizuar nga 10/02/2011 deri 10/02/2046. Me datë 02/04/2013 është publikuar akti i blerjes së 80% të kuotave të kapitalit të kësaj shoqërie, nga Shoqëria “Katër Grykët” sh.p.k.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga :

Shoqëria “Katër Grykët” sh.p.k., zoteruese e 80 Kuotave, qe perbejne 80% te kapitalit dhe Shoqëria “Sigers” sh.p.k., zoteruese e 20 Kuotave, qe perbejne 20% te kapitalit.

Administrator i shoqerise eshte Z. Robert Lala, me afat emerimi nga 19.09.2013-17/02/2025.

Kohëzgjatja: nga 10/02/2011 deri me 10/02/2046.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte: Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Germani 1 dhe "Germani 2", tek Autoriteti Kontraktues (M.I.E), ku perfshihet financimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpermdarja, eksportimi, dhe shitja e energjise elektrike, ne zbatim te Kontrates Koncesionare Nr.83 Rep, Nr.61 Kol, date 10.01.2011(Nuk lejohet asnje lloj tjeter veprimtarie tregtare pervec atyre qe ushtrohen ne kuader te kesaj Kontrate) të nënshkruar nga kjo shoqeri dhe Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës (M.E.T.E.), ne zbatim te kontrates se Koncesionit te formes BOT te dhene nga Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes e autorizuar nga Keshilli i Ministrave, per shfrytezimin e ujit per prodhimin e energjise elektrike, me shfrytezimin e rrjedhjes ujore te perroit zalli i Germanit, Rrethi Mat.

Me date 18 Dhjetor 2018, Shoqeria ka nenshkruar Kontrate Shtese Koncesioni Nr.2570 Rep, Nr.1224.3 Kol, Per nje ndryshim ne kontraten e Koncesionit te formes BOT te vitit 2011 dhe te gjitha kontratat me pas, per ndertimin e hidrocentraleve “Germani 1” dhe "Germani 2", ne te cilen Autoriteti Kontraktues nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës (M.E.T.E.) behet Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë (M.I.E) .

Me Vendimin Nr. 92 Datë 06.10.2014, Enti Rregullator i Energjise, vendosi të liçensojë shoqërinë “SA’GA-MAT” sh.p.k. në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et “German 1” me fuqi 1,2 MW, “German 2” me fuqi 1,68 MW, “German 3” me fuqi 1,29 MW dhe “German 4” me fuqi 0,81, me fuqi totale 4.98 MW për një afat 30- vjeçar.

Me date 18/10/2019 shoqëria “SA’GA-MAT” sh.p.k dhe OSHE sh.a. kane nenshkruar kontraten nr.9053/4, “Per shitblerje të energjisë elektrike ndermjet OSHE dhe prodhuesve me përparësi të enegjise elektrike”, me afat 15 vjet, nga data 18/10/2019-17/10/2033 (neni 15 i kontrates), per blerjen e energjise qe prodhohet nga “SA’GA-MAT” sh.p.k. me çmime te miratuara nga ERE.

Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresen: Rruga Albanopoli, pall. Kater Gryket, Nr.24, afer shkolles Qazim Turdiu, në Tiranë, ndërsa adresa ku zhvillohet biznesi gjendet në Perroi Zalli i Germanit, zona kadastrale 1646, numer pasurie 2688, Mat.

Numri i punonjesve me date 31 Dhjetor 2020 eshte 7 punonjes (31 Dhjetor 2019:8 punonjes), ndersa numri mesatar i punonjesve per vitin 2020 ishte 8.4 punonjes.

2. BAZA E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”). Shoqëria mban kontabilitetin dhe raporton pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 64 datë 22.07.2014 dhe në mbështetje te Ligjit Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me efekt nga data 1 janar 2019.



Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar (“Lek”), e cila është edhe monedha funksionale e Shoqërisë si rrjedhojë e mjedisit ekonomik ku ajo operon, dhe të gjitha vlerat janë rrumbullakosur në Lek, përveç aty ku shprehet ndryshe.

Vijimesia

Drejtimi i Shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë për të vazhduar aktivitetin në vijimesi dhe vlerëson që Shoqëria ka burime dhe perspektive për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk është në dijen të ndonjë paisigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimesi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në baze të parimit të vijimesisë.

Kompesimi (netimi)

Aktivitetet dhe detyrimet financiare janë të kompensuar me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëqoftëse është e drejtë ligjore për të kompensuar shumën e njohur dhe ka një synim për t’i mbyllur ato mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivitetet dhe të shlyejë detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë kompensuar në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard kontabiliteti apo interpretim, dhe në mënyrë specifike në ndonjë nga politikat kontabël të Shoqërisë.

Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:

(a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;

(b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit dhe i zhvlerësimeve të aktiveve;

(c) krijimi i provizioneve për shpenzime ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces. Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykim për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njih detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumën që është regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

3. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

(a) Transaksionet në monedhë të huaj


Rregjistrimet kontabël të njësive janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31 Dhjetor, si vijon:

Monedha
EUR

31.12.2020
123.7

31.12.2019
121.77



Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të regjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

(b) Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç’regjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose me pak. Për qëllime të pasqyres së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të percaktuara me lart, pasi i zbritet teprica e paradhënieve bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

Huamarrjet dhe parapagimet

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me kosto. Detyrimet financiare maten me kosto, dhe më pas, me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me kosto dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

Te tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(c) Aktivet Afatgjata investimi

Aktive afatgjata investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratë dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke

përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen të shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet aftagjata investimi maten me modelin e koston. Aktivet aftagjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrët shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivitetit në kushtet për tu dhënë me qera.

(d) Aktive aftagjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet aftagjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve aftagjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivitet aftagjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve aftagjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet aftagjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot ne vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitet aftagjatë material regjistrohen me vlerën kontabël të aktivitet në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç’regjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve regjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitet ose çdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

- | | |
|----------------------------|-----|
| a) Moblije dhe Paisje zyre | 20% |
| b) Pajisje informatike | 25% |
| c) Godine | 5% |

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsis trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivitet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve aftagjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(e) Aktive aftagjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar. Shoqëria ka njohur investimin e kryer për ndërtimin e HEC German 1 dhe HEC German 2, si një aktiv jomaterial, si një të drejtë për përdorimin e një aktivitet HEC që ajo ka ndërtuar dhe po ndërton dhe më pas e përdor për një periudhë kohe të specifikuar deri ne vitin 2046. Kko e drejtë për t’i tarifuar përdoruesve nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë mjete monetare sepse shumat janë të kushtëzuara në masën në të cilën shoqëria shet energjinë e prodhuar.

Kostot ne vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e drejte te aktivitet, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, përgjatë viteve që ky aktiv pritet të jete ne dispozicion te operatorit per ta përdorur (deri ne vitin 2046). Amortizimi njihet në shpenzime duke përdorur metodën lineare, per 27.25 vite perdorimi per HEC German 1, duke marre ne konsiderate kohen e perdorimit per turbinat deri ne kohen e ri-investimit te kesaj pjese te aktivitet. Amortizimi per HEC German 2 nuk ka filluar ende, pasi aktivi eshte ne proces. Ne vitin 2046 aktivi do te transferohet tek dhenesi i koncensionit.

(f) Zhvleresimi

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënie e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitet, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

(g) Marrëveshjet Konçesionare

Konçesionet e shërbimeve

Një marrëveshje konçesionare e shërbimeve është një marrëveshje ku qeveria ose një organ tjetër i sektorit publik (konçesiondhënësi) kontraktin një operator privat për të ndërtuar (ose përmirësuar), përdorur dhe mirëmbajtur aktivitet e infrastrukturës së konçesiondhënësit si rrugë, ura, tunele, aeroporte, rrjete të shpërndarjes së energjisë, burgje apo spitale. Në këto marrëveshje, konçesiondhënësi kontrollon ose rregullon çfarë shërbimesh duhet të ofrojë operatori duke përdorur aktivitet, kujt duhet t’ia sigurojë dhe me çfarë çmimi, dhe gjithashtu kontrollon çdo interes të mbetur domethënë në aktive në fund të afatit të marrëveshjes.


Ka dy kategori kryesore të marrëveshjeve konçesionare të shërbimeve:

Në njërën, operatori merr një aktiv financiar, një të drejtë kontraktuale të pakushtëzuar për të marrë një shumë specifike ose të përcaktueshme fluksesh monetare ose një aktiv tjetër financiar nga qeveria në këmbim të ndërtimit ose përmirësimit të një aktivi të shërbimit publik dhe më pas duke përdorur dhe mirëmbajtur aktivin për një periudhë kohe të specifikuar. Kjo kategori përfshin garanci nga qeveria për të paguar për çdo mungesë ndërmjet shumave të marra nga përdoruesit e shërbimit publik dhe shumave të specifikuara apo të përcaktueshme.

Në tjetrën, operatori merr një aktiv jo-material, një të drejtë tarifimi për përdorimin e një aktivi të sektorit publik që ai ndërton ose përmirëson dhe më pas e përdor dhe e mirëmban për një periudhë kohe të specifikuar. Një e drejtë për t’i tarifuar përdoruesve nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të marrë mjete monetare sepse shumat janë të kushtëzuara në masën në të cilën publiku përdor shërbimin.

Referuar natyrës së kontrates që ka ne zbatim shoqëria, ajo e ka trajtuar atë bazuar në Modelin e aktivitet jomaterial. Sipas këtij modeli, Operatori (shoqëria) duhet të njohë një aktiv jo-material në masën që i jep atij të drejtën (licensën) për të tarifuar përdoruesit e shërbimit publik. Operatori duhet fillimisht të masë aktivin jo-material me vlerën e drejtë. Më tej për kontabilizimin e aktivitet jomaterial, operatori duhet të zbatojë kërkesat e SKK5 Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jomateriale.

Aktivitet jo financiare



Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit ose e njësisë të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(h) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqëria njihet si detyrim shumë e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(i) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(j) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktivitetit të biznesit.

(k) Të ardhurat nga shitja

Operatori i një marrëveshje konçesionare të shërbimeve duhet që, për shërbimin që ai kryen, të njohë, masë dhe deklarojë të ardhurat në përputhje me SKK 8 Të Ardhurat. Të ardhurat nga shitja e produkteve (energji elektrike) njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Energjia e prodhuar shitet çdo muaj. Tarifa konçesionare e cila llogaritet si 2.5% e vlerës së të ardhurave të realizuara, është paraqitur në shpenzime.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet të ofruara.

(l) Të ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(m) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me ndërtimin e aktivitetit, të cilat duan një kohë të gjatë për t’u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje. Ky trajtim është ndjekur nga shoqëria për njohjen e AAJM nga kontrata koncesionare. Te gjitha kostot e interesit deri në datën e përfundimit të fazës së parë të ndërtimit janë kapitalizuar.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(n) Taksat

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundur që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivitetet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundur që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

SHENIME SHPJEGUESE

4. Mjete monetare dhe ekuivalente me to

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Mjete monetare në bankë	14,927,696	18,923
Mjete monetare në arkë	1,369,984	0
	<u>16,297,681</u>	<u>18,923</u>

Vlera e mesiperme përfaqëson vlerën e likuiditeteve me date 31.12.2020, gjendje në llogaritë që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në leke dhe valute si dhe gjendjen në arke. Gjendja e likuiditeteve e paraqitur në bilanc rakordon me shumën e sipas dokumentave të bankës.

5. Kërkesa për arkëtim nga veprimtaria e shfrytëzimit

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Llogaritë e arkëtueshme	9,791,851	0
	<u>9,791,851</u>	<u>0</u>

Në këtë rubrikë janë paraqitur kërkesat neto për tu arkëtuar nga klienti F.T.L. Sha për shitjen e energjisë elektrike Dhjetor 2020. Arkëtimi i kërkesave është sipas afateve të kontratës.



6. Kërkesa të tjera për arkëtim

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
TVSH per tu marre	27,148,926	1,557,473
Parapagime ne Dogane	334,877	
Hua pa interes	20,000	20,000
Debitore te tjere	0	101,000
	<u>27,503,802</u>	<u>1,678,473</u>

Ne kete rubrike jane paraqitur kerkesat per tu arketuar nga shteti per TVSH me vlere 27,148,926 Leke, parapagim ne dogane per 334,877 Leke si dhe debitore te tjere.

7. Inventari

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Materiale	256,378	43,214
Parapagime per furnizim materialesh	14,300,642	22,031,366
	<u>14,557,020</u>	<u>22,074,580</u>

Sikurse shihet nga tabela gjendja e inventareve ne magazine është e ulët (256,378 Leke). Vlerën më të rëndësishme në këtë grup e zënë parapagimet per blerje materialesh te para, nje pjese e te cilave jane mbyllur gjate periudhes Janar-Maj 2020, pasi jane kryer importet e parashikuara, ndersa te tjerat nuk jane kompletuar ende.

8. Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Llogaritë e arkëtueshme te pafaturuara	0	10,823,937
	<u>0</u>	<u>10,823,937</u>

Ne 31.12.2029 ne kete rubrike ishin paraqitur kerkesat neto per tu arketuar nga OSHEE per faturen e energjise elektrike te prodhuar ne Dhjetor 2019, por te faturuar me date 09.01.2020 dhe arketuar po ne vitin 2020.

9. Aktivët afatgjata materiale dhe jo materiale (AAM dhe AAJM)

Aktivët afatgjata materiale perbehen nga aktive qe perdoren per qellime administrative si mobilje e pajisje zyre e pajisje informatike.

Aktivët afatgjata jo-materiale të ndertuara nën një kontratë koncensionit, perfaqësojnë të drejtën (licensën) për t’ju tarifuar përdoruesve të shërbimit publik vlerën në shitje të energjise te prodhuar nga HEC-i i ndertuar nga shoqeria, per llogari te M.E.T.E. Koncensiondhënësi (M.E.T.E.) kontrollon dhe rregullon shërbimet e operatorit privat, siguron kujt i shitet produkti dhe me çfarë cmimesh, si dhe kontrollon interesin e mbetur në fund të kontratës.

Me poshte eshte paraqitur amortizimi i HEC German 1, i cili llogaritet në bazë të afatit të mbetur të kontratës së koncensionit, duke filluar nga data e vënies në përdorim te AAJM deri ne vitin 2046. Nuk eshte llogaritur amortizim per HEC German 2, ndërtimi i tij perfundoi ne Dhjetor 2020 dhe eshte vene ne pune ne janar 2021. Detyrimi i operatorit sipas kontrates koncensionare për ndertimin e dy HEC-ëve, kompletohet me përfundimin e fazës së dytë të projektit te HEC German 2.

“SA’GA-MAT” SH.P.K.

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020

(Vlerat jane ne LEKE)

Aktive afatgjata	AAM	AAJM-E drejtë German 1	AAJM-ne proces German 2	Totali
Gjendje 31.12.2018	0	342,561,191	0	342,561,191
Shtesa	1,941,997		10,965,684	12,907,681
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2019	1,941,997	342,561,191	10,965,684	355,468,872
Shtesa			194,800,749	194,800,749
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2020	1,941,997	342,561,191	205,766,433	550,269,621
Amortizimi dhe zhvleresimi				
Gjendje 31.12.2018	0	-3,103,479	0	-3,103,479
Shtesa	-141,869	-15,345,841	0	-15,487,710
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2019	-141,869	-18,449,320	0	-18,591,189
Shtesa	-292,177	-15,345,841	0	-15,638,018
Pakesime				0
Gjendje 31.12.2020	-434,046	-33,795,161	0	-34,229,207
Vlera neto 31.12.2019	1,800,128	324,111,871	10,965,684	336,877,683
Vlera neto 31.12.2020	1,507,951	308,766,030	205,766,433	516,040,413

10. Detyrime ndaj institucioneve të kredisë

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Pagesa afatshkurter per ISP, HAGJ 1	10,935,629	9,851,322
Pagesa afatshkurter per ISP, HAGJ 2	16,459,654	0
Interesa te perlllogaritura	2,465,149	1,411,344
	29,860,432	11,262,666

Shoqeria "SA’GA-MAT" shpk ka vijuar huamarrjen nga Intesa San Paolo Bank edhe gjate vitit 2020. Me date 09.10.2019 shoqeria ktheu gjithë huane ekzistuese e cila e kishte afatin deri me 10/05/2019 per shumën 1,050,000 Eur. Njekohesisht ka vijuar huamarrjen nga Intesa San Paolo Bank sipas kontrates se kredise nr. 2505/2 REP, nr.994 Kol, date 27.09.2019, per shumen 115,889,900 Leke, me afat 11 Tetor 2019-11 Tetor 2028, me keste kthimi cdo tremujor, me normë interesi te ndryshueshme 1 here ne vit, e cila per vitin 2020 ishte 5.25%. Detyrimi ndaj Bankes me 31.12.2020 per kete kredi ishte 106,038,578.31 Leke (ISP,HAGJ 1) nga e cila pjesa e pagueshme per vitin 2021 eshte 10,935,629 Leke.

Njekohesisht ka vijuar huamarrjen nga Intesa San Paolo Bank sipas kontrates se kredise nr. 2506/3 REP, nr.995 Kol, date 27.09.2019, per ekuivalentin ne LEK te shumes 1,500,000 EUR ne daten e disbursimit, e cila me date 29 janar 2020 ishte 183,750,000Leke, me afat 29 Janar 2020-29 Korrik 2029, me keste kthimi cdo tremujor, me normë interesi te ndryshueshme 1 here ne vit, e cila per vitin 2020 ishte 5.25%. Detyrimi ndaj Bankes me 31.12.2020 per kete kredi ishte 182,239,792.27 Leke (ISP,HAGJ 2) nga e cila pjesa e pagueshme per vitin 2021 eshte 16,459,654 Leke.

Interesat e perlllogaritura me vlere 2.465.432 Leke, perfaqesojne detyrimin per interes per periudhen 3 Nentor-31 Dhjetor 2020, per te 2 huate.

Në këtë rubrikë është paraqitur vlera e principalit të pagueshëm gjatë vitit 2021, ndersa pjesa tjetër është klasifikuar tek detyrimet afatgjata. Pagesat e huase jane kryer ne afat, sipas kontratës. Ky shenim te lexohet se bashku me shenimin nr.15 ne vijim, qe perfaqeson detyrimin afatgjate per hua, pas dates 31.12.2020.

11.Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Kater gryket shpk	59,301,486	42,157,612
Rafaelo	0	308,152
Alba Eletrika	198,385	72,811
EBS	0	440,964
ATB Riva Calzoni	6,883,905	0
Hodaj Energji	990,245	0
Furnitore te tjere	1,746,824	0
Shpenzime te perlllogaritura	240,000	0
	<u>69,360,846</u>	<u>42,979,539</u>

Ne kete rubrike jane paraqitur detyrimet ne total te shoqerise ndaj furnitoreve, të lidhura më aktivitetin i shfrytëzimit, pjese e te cilave eshte detyrimi ndaj shoqerise Kater Gryket shpk, me vlere 59,301,486 Leke (Ref.11.2), e cila eshte pale e lidhur me shoqerine.

12.Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve

	31 Dhjetor 2020	31.Dhjetor 2019
Detyrime ndaj personelit	0	291,670
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore/shëndetsore	95,774	86,658
	<u>95,774</u>	<u>378,328</u>

Detyrimet per sigurime shoqerore dhe shendetesore, perfaqesojne detyrime te muajit Dhjetor 2020, te paguara ne Janar 2021.

13.Të pagueshme për detyrimet tatimore

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Tatim fitimi	1,235,748	2,890,490
Tatim page	17,325	10,218
	<u>1,253,073</u>	<u>2,900,708</u>

Per llogaritjen e detyrimeve tatimore sipas shenimit 12 dhe 13, shoqeria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit “Per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore”, “Per TVSH-ne”, per “Tatimin mbi te ardhurat” etj, te zbatueshme per aktivitetin e shoqerise. Keto detyrime perfaqesojne detyrime te muajit Dhjetor 2020, te cilat jane paguar ne Janar 2021 me perjashtim te tatim fitimit i cili eshte paguar me vone.

14.Hua te tjera

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Renewable energy	885,350	986,350
Flutura Lala	4,000,000	4,000,000
	<u>4,885,350</u>	<u>4,986,350</u>



Në këtë rubrikë janë paraqitur detyrimet për hua afatshkurër ndaj të tretëve.

15. Hua afatgjate nga institucioneve e kredisë

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Hua nga Intesa San Paolo Bank HEC 1	106,038,618	115,889,900
Zbritet-principali i pagueshem afatshkurter	-10,935,629	-9,851,322
Hua nga Intesa San Paolo Bank HEC 2	182,239,793	0
Zbritet-principali i pagueshem afatshkurter	-16,459,654	0
	<u>260,883,128</u>	<u>106,038,578</u>

Ky shenim te lexohet se bashku me shenimin nr.10, dhe perfaqeson detyrimin afatgjate per hua ndaj Intesa San Paolo Bank, të pagueshme pas datës 31.12.2021 referuar kontratave perkatese.

16. Të pagueshme ndaj ortakeve

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Hua e marre nga Kater Gryket shpk	<u>175,482,909</u>	<u>175,482,908</u>
	<u>175,482,909</u>	<u>175,482,908</u>

Shoqëria Kater Gryket shpk, në cilësinë e ortakut të kësaj shoqërie, ka financuar pjesërisht ndërtimin e HEC German 1, sipas kontratës së koncensionit. Kthimi i saj do te behet ne varesi te situates se likujdetit te shoqerise, natyrisht pas permbushjes se detyrimeve te tjera ne afat, sipas kontratave respektive.

17. Kapitali

		31 Dhjetor 2020		31 Dhjetor 2019
Shoqeria Kater Gryket shpk	80%	80,000	80%	80,000
Shoqeria Sigers shpk	20%	20,000	20%	20,000
Total		<u>100,000</u>		<u>100,000</u>

Nuk ka ndryshim ne kapitalin e shoqerise si dhe strukturen e tij per vitin 2020 krahasuar me vitin 2019.

18. Fitimi/Humbja e pashpërndarë

Vlera e Fitimit te pashperndare me date 31.12.2020 eshte 27,444,519 Leke ndersa vlera e humbjeve me date 31.12.2019 ishte -1,183,041 Leke. Kjo Humbje, referuar vendimit te Asambjese se Ortakeve, eshte mbuluar nga fitimi i vitit 2019 me vlere 28,627,560 Leke. Pjesa e mbetur e tij prej 27,444,519 Leke nuk eshte shpendare.

Fitimi i Vitit

Vlera e fitimit neto me 31.12.2020 eshte 14,924,736 Leke, ndersa me date 31.12.2019 ishte 28,627,561 Leke. Kjo renie e fitimit ka ardhur si rezultat i renies se te ardhurave nga shitja e energjise hidrike gjate vitit 2020 me vlere 22,730,786 Leke, ose 32.4% me pak te ardhura se ne vitin 2019. Gjate vitit 2020, HEC-German 1 ishte ne shfrytezim me perjashtim te muajive te stines se veres, kur nuk prodhohet energji. Ne Janar 2021 eshte vene ne shfrytezim HEC-German 2, i cili pritet te jape impakt pozitiv ne te ardhurat e ketij viti.

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Te ardhura nga shitja e energjise elektrike	46,284,621	68,515,417
	<u>46,284,621</u>	<u>68,515,417</u>

Gjate vitit 2020 ka patur prodhim dhe shitje të energjisë elektrike me çmimet e rregulluara (miratuar) nga ERE (Enti Rregullator i Energjise), i cili është organi kompetent per vendosjen e çmimit vjetor të tregëtimit të energjisë elektrike të prodhuar dhe sipas matjeve te kryera nga OST.

20. Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Punime te kryera per ndertimin e HEC-German 2	194,800,749	0
	<u>194,800,749</u>	<u>0</u>

Gjate vitit 2020 shoqëria ka kryer investimin per ndertimin e HEC-Germani 2 dhe ka vetefaturuar kostot e kryera per materiale, sherbime e kosto financiare, ne vleren sa me lart, per nevoja te saj.

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Blerje materialesh dhe sherbimesh per ndertimin e HEC 2	-194,563,394	0
Blerje materiale kons. e te tjera (karburant)	0	-3,160,117
	<u>-194,563,394</u>	<u>-3,160,117</u>

Ne kete rubrike jane paraqitur kostot e kryera per materiale, sherbime e kosto financiare, per ndertimin e HEC-Germani 2. Ky shenim te lexohet me shenimin nr.20.

22. Shpenzime të tjera operative

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Shpenzime qiraje	-210,000	-1,100,220
Sherbime mirembajtje	-129,688	0
Sherbime te ndryshme, interneti, etj	-138,747	-651,945
Sigurime	-165,300	-60,000
Sherbim konsulence, noterizime etj	-440,000	-526,065
Tarifa koncesionare	-1,157,303	-1,712,868
Taksa dhe tarifa vendore, etj	-479,030	-808,960
Shpenzime te tjera	-89,329	-140,013
	<u>-2,809,398</u>	<u>-5,000,071</u>

Vleren me te rendesishme ne kete rubrike e zene shpenzimet per tarifen koncensionare, e llogaritur si 2.5% e vleres se prodhimit vjetor te energjise, si dhe taksat vendore, etj. Tarifa e auditimit e paguar ne vitin 2020 ishte 200,000 Leke, pa tvsh.

23. Te ardhurat financiare neto janë të përbëra si më poshtë:

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Fitimi neto nga veprimet ne valute	1,604,726	529,232
Te ardhura nga interesi	13,908	0
	<u>1,618,635</u>	<u>529,232</u>

24.Kosto financiare neto

Kostot financiare neto janë të përbëra si më poshtë:

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Shpenzime interesi per huane bankare	-6,122,759	-7,167,925
	<u>-6,122,759</u>	<u>-7,167,925</u>


Shpenzimet e interesit jane të lidhura ne huanë e marre nga ISP Bank dhe lidhet me HEC-German 1, i cili eshte vene ne shfrytezim.

25. Tatimi mbi fitimin

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Fitimi /Humbja para tatimit	17,602,101	33,679,482
<i>Shpenzime të pazbritshme</i>	247,001	0
Totali i shpenzimeve të pazbritshme	247,001	0
Humbje te mbartura	0	0
Fitimi i tatueshem	17,849,102	33,679,482
Norma e tatimit 15 %	15%	15%
Shpenzimi për tatim fitimin	-2,677,365	-5,051,922
Fitimi neto	14,924,736	28,627,560

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2020 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 eshte 15%. Niveli taksimit per fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2019 ka qënë 15%. Përlllogaritjet e Tatimit mbi Fitimin për vitin ushtrimor janë bazuar ne elementet e paraqitura ne kete pasqyre. Shoqeria ka paguar gjate vitit tatim fitimi per llogari te vitit 2020 shumen 1,441.617 Leke (viti 2019: 2,161,432 Leke), ndersa diferenca prej 1,235,748 Leke (31.12.2019: 2,890.490 Leke), eshte paraqitur te detyrimet tatimore ne shenimin nr.13.

26. Transaksione me palet e lidhura



Shoqeria ka kryer transaksione me palet e lidhura , per parapagime me vlere 13,016,940 Leke (shenimi nr.7), per marrje huaje (shenimi nr.14 dhe 15), per furnizime te sherbimeve te ndertimit (shenimi nr.14 dhe 16) dhe per qerane e selise me vlere 210,000 Leke (shenimi nr.22).

Paga bruto e administratorit per vitin 2020 ishte 1,043,500 Leke (viti 2019 : 984,000 Leke).

27. Angazhimet dhe detyrimet e kushtezuara

Me date 31 Dhjetor 2020, Shoqeria ka detyrime per hua afatgjate ndaj Intesa S.P. Bank, sipas kontratave te kredise te komentuar ne shenimin nr.10, vlerat e te cilave jane raportuar ne shenimin nr.10 dhe 15 te ketyre pasqyrave.

Shoqeria dhe Banka kane nenshkruar Marreveshjen Siguruese Nr. 2510 Rep. Nr. 999 Kol., date 27.09.2019.

Shoqeria ka vendosur hipoteke te rradhes se pare mbi sendin e ardhshem ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredite e permendura ne shenimin nr.10 dhe 15 te ketyre pasqyrave. Shoqeria ka vendosur barres siguruese te radhes se pare ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredite e lartpermendura mbi linjat e prodhimit, makinerite, pajisjet, impiantet dhe çdo pasuri tjeter te luajtshme te tashme dhe te ardhshme (asetet e Koncesionit). Shoqeria ka vendosur barre siguruese te rradhes se pare ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredite e lartpermendura mbi "llogarite rrjedhese te çelura aktualisht apo qe mund te çelen ne te ardhmen prane Bankes si dhe te ardhurat e arketueshme te tashme po te ardhshme si dhe te gjitha te drejtat dhe pretendimet mbi to". Shoqeria ka vendosur barre siguruese te radhes se pare ne favor te Bankes me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kredite e lartpermendura mbi "kuotat e shoqerise".

28. Vijimesia e aktivitetit

Përgatitja e pasqyrave financiare eshte bazuar ne kerkesat e SKK-ve per pasqyrat individuale te shoqerive. Drejtimi gjykon qe jane permbushuar kriteret qe shoqeria të vazhdoje në vijimësi aktivitetin e saj.

29. Rreziku nga Taksimi

Legjislacioni tatimor shqiptar është subjekt i interpretimeve të ndryshme dhe ndryshime që ndodhin shpesh. Si rezultat, transaksionet mund të rivleresohen nga organet tatimore dhe Shoqëria mund të duhet të paguaj taksa shtesë, gjobat dhe interesa, të cilat mund të jenë të rëndësishme. Periudhat mbeten të hapura për të shqyrtuar nga organet tatimore dhe doganore në lidhje me detyrimet tatimore për pesë vjet. Manaxhimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të asnjë rrethanë, të cilat mund të sjellin një detyrim të mundshëm material në këtë drejtim.

30. Ngjarjet pas dates se bilancit

Deri ne daten e mbylljes se pasqyrave financiare me date 28 Shkurt 2021, nuk ka patur ngjarje te cilat te ndikonin ne gjendjet e deklaruar nga shoqeria me date 31.12.2020 dhe ne shenimet shpjeguese te perfshira ketu.

Keto pasqyra financiare u autorizuan nga administratori i shoqerise me date 28 Shkurt 2021.


Ekonomist

Jurgen Muliu



Administrator

Robert Lala



“SA‘GA-MAT” SH.P.K.
Pasqyrat financiare per vitin e mbylltur me 31 Dhjetor 2018
(Vlerat jane ne LEKE)
